

 <p>DAV Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p>POLITIKA E VLERËSIMIT</p>	Kodi DA-PO-002
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 1 nga 3

POLITIKA E VLERËSIMIT

1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Akreditimit në lidhje me vlerësimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit si laboratorët testues, kalibrues, organizmave certifikues të sistemeve të cilësisë, produkteve dhe personelit dhe organizmave inspektues.

2. Referimet

ISO/IEC 17011 “Kërkesa të përgjithshme për organizmat e akreditimit që akreditojnë organizmat e vlerësimit të konformitetit”, paragrafi 7.3.1

3. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit të cilat përdoren për vlerësimin e kompetencës teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit janë:

Nr	Tipi i organizmit	Kriteret	Udhëzues të EA/ILAC
1	Laboratorët testues	S SH ISO/IEC 17025:2005	EA: 02/03, 02/05, 02/07, 02/10, 03/09, 04/07 ILAC: G2:1994, G8:1996
2	Laboratorët kalibrues	S SH ISO/IEC 17025:2005	EA: 04/02 dhe varet nga lloji i kalibrimit që ofrohet seria 10/01-10/16
3	Laboratorët mjekësor	S SH ISO/IEC 17025:2005 dhe S SH ISO 15189	EA: 04/12
4	Organizmat inspektues	S SH EN 45004:1997	EA: 5/01, 5/02
5	Organizmat certifikues të sistemeve të cilësisë	S SH EN 45012:1007	EA 7/01
6	Organizmat certifikues të produkteve	S SH EN 45011:1997	EA: 6/01
7	Organizmat certifikues të personelit	S SH ISO 17024:2003	EA: 8/01

 <p>Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p>Politika e vlerësimit</p>	<p>Kodi DA-PO-002</p> <hr/> <p>Rishikim nr 0 Dt ____/____/____</p> <hr/> <p>Faqe 2 nga 3</p>
---	-------------------------------------	---

4. Vlerësimi

- 4.1 Drejtoria e Akreditimit duhet të ofrojë shërbimin e akreditimit me profesionalizëm, integritet dhe në mënyrë të përshtatshme.
- 4.2 Vlerësimi bazohet në kriteret e vendosura në pikën 3.
- 4.3 Në mënyrë që shërbimi i akreditimit të kryhet me cilësinë e duhur grupi i vlerësimit duhet të plotësojë kërkesat e kodit të përcaktuara në pikën 5.
- 4.4 Kërkesat e kodit duhet të plotësohen nga vlerësuesit gjatë kohës së kryerjes së vizitave vlerësuese/mbikqyrëse/rivlerësuese në organizma.
- 4.5 Drejtoria e Akreditimit ka të drejtën të kryejë vizita shtese të palajmëruara për të monitoruar efektivitetin e zbatimit të sistemit të menaxhimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit. Vizitat shtesë të palajmëruara nuk kanë të lidhura me ankesat apo ndryshimet që mund të ndodhin në organizëm dhe që mund të ndikojnë në përputhshmërinë e sistemit të menaxhimit me kërkesat e standardeve.

5. Kodi i vlerësuesve

- 5.1 Vlerësuesi duhet të jetë i ndërgjegjshëm që prezanton Drejtorinë e Akreditimit.
- 5.2 Çdo sqarim në lidhje me polikat dhe procedurat e DA duhet ti kerkojë në mënyrë private me DA.
- 5.3 Duhet të komunikojë në mënyrë profesionale, miqësore dhe të kontrolluar me stafin e organizmit që vlerësohet.
- 5.4 Duhet të prezantojë gjetjet dhe moskonformitetet në mënyrë të qetë dhe të arsyetuara.
- 5.5 Cdo mosmarrëveshje me stafin e organizmit që vlerësohet duhet të zgjidhet më qetësi dhe në mënyrë të arsyeshme. Në rast moszgjidhjeje vlerësuesi duhet t'i shpjegojë organizmit procedurën e apelimeve të DA.

5.6 Duhet të ketë parasysh se nëse jep këshilla ato nuk duhet të kalojnë në konsulencë.

 Drejtoria e Akreditimit Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al	Politika e vlerësimit	Kodi DA-PO-002
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 3 nga 3

5.7 Duhet të ketë parasysh kohën e planifikuar për vizitën vlerësuese duke e menaxhuar atë sipas planit. Nëse shikohet e arsyeshme zgjatja e kohës së vlerësimit kjo do të arrihet vetëm në konsultim me stafin e organizmit që vlerësohet.

5.8 Duhet të ketë parasysh që qëllimi i vizitës është të vlerësojë kompetencën teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit. Vizita vlerësuese nuk duhet të përdoret për të treguar kompetencën dhe njohuritë e vlerësuesve.

5.9 Duhet të jenë të vëmendshëm.

5.10 Nuk duhet të kontaktojnë në asnjë kohë me organizmin e vlerësimit të konformitetit përveç vizitës vlerësuese pa lejen e DA.

5.11 Nuk duhet t'u japin kartat e tyre të biznesit organizmit që vlerësohet

5.12 Duhet të zbatojnë të gjitha afatet e përcaktuara nga Drejtoria e Akreditimit për dorëzimin e raporteve dhe formave.

Data

Drejtori i Përgjithshëm